



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
dhe
Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

Tiranë, më 23.10.2018

Dokument Parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9518, DATË 18.4.2006
“PËR MBROJTJEN E TË MITURVE NGA PËRDORIMI I ALKOOLIT”, TË
NDRYSHUAR”**

- Hyrje

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në cilësinë e Komisionit përgjegjës së bashku me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik morën në shqyrtim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, të ndryshuar bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë së bashku me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik caktuan relatoren e përbashkët për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Znj. Adelina Rista.

Projektligji u paraqit në komision nga propozuesi i tij deputeti Z. Erion Brace. Mbrojtja e projektligjit, dhënia e shpjegimeve për pyetjet e anëtarëve të dy Komisioneve u ndërmor nga vetë deputeti Z. Erion Brace.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga një deputet, sipas përcaktimeve të neneve 81- 83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT E TIJ

2.1 Qëllimi i projektligjit

Projektligji i propozuar për amendimin e ligjit nr. 9518, datë 18.4.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, të ndryshuar ka si qëllim:

- *Parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, duke ndaluar përdorimin e pijeve energjike dhe kufizuar marketingun si të pijeve energjike, ashtu dhe të pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, nga të miturit.*

Gjatë viteve të fundit konsumi i pijeve energjike është rritur ndjeshëm. Bazuar në studimet e fundit, pijet energjike përbëjnë 20% të produkteve ushqimore që gjenden në treg. Këto të dhëna cojnë në konkluzionin se në treg gjithashtu rritet dhe rreziku toksik nga taurina ose mbidoza nga kafeina.

Instituti i Shëndetit Publik në raportimin e tij të fundit jep disa të dhëna mjaft shqetësuese në lidhje me nivelin e konsumit nga të miturit të pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar dhe pijeve energjike. Në raportin e fundit të publikuar nga ky institut "Iniciativa e survejancës së obezitetit në moshën fëmimore (COST), rezultatet e vitit 2016", ku u analizua tendenca e mbipeshës dhe obezitetit mes fëmijëve shqiptarë të moshës 8.0-8.9 vjec u vunë re karakteristikat mjedisore lidhur me ushqyerjen dhe aktivitetin fizik të fëmijëve në mjediset shkollore dhe treguesit mbi konsumin e ushqimeve dhe pijeve tek fëmijet si dhe shkallës së aktivitetit të tyre fizik. Nga të dhënat e raportit rezultonte se: 40% e fëmijëve konsumonin pije freskuese me sheqer më pak se një herë në javë, 26 % disa ditë (1-3 ditë), 7% (4-6 ditë në javë) dhe 6,4 % cdo javë.

Ndër faktet më problematike që del nga analizimi i raportet të Institutit të Shëndetit Publik është që edhe pse 86,4% e shkollave të survejuara raportojnë se zhvillojnë si pjesë të kurrikulës së tyre mësimore edukimin mbi ushqyerjen, lejojnë tregtimin brenda mjediseve të shkollës si të pijeve energjike ashtu edhe të pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar. Kështu 22, 4% e shkollave të survejuara krijojnë rrethësi që në ambjentet e shkollës të shpërndahen me pagesë pije të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar, ndërsa për pijet energjike ky nivel është në masën 24%. Këto pije janë po aq lehtësisht të aksesueshme sa uji, lengjë e frutave pa sheqer të shtuar apo dhe frutat e freskëta.

2.2 Risitë e projektligjit

Projektligji i sjellë nga deputeti Z. Erion Brace sjell risitë e mëposhtme:

- a. Dhënien sa më qartë sipas përkufizimeve ndërkombëtare të konceptit të “pijeve energjike” dhe “pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”.
- b. Parandalimin e rasteve abuzive nga persona madhorë që shoqërojnë të miturit në vende publike në ofrimin ndaj tyre të pijeve alkoolike si dhe të pijeve energjike. Rastet e personave madhorë që janë abuzues të dënohen me gjobë dhe kjo vepër të konsiderohet kundërvajtje administrative.
- c. Kufizimi i publicitetit në media për pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar si dhe kufizime të ngjashme në institucionet arsimore për të mitur, salla kinemaje apo teatër, gjatë shfaqjeve për moshat e mitura

- d. Reklamimi i pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar drejtuar të miturve në mjedise si rrugë, parqe, e më gjërë të përbërje kundërvajtje administrative dhe të dënohet me gjobë që varion nga 100 mijë në 200 mijë lekë.
- e. Detyrimi i subjekteve që tregojnë pije energjike për të vendosur detyrimin për mbajtjen e tabelave treguese "Ndalohej shitja e pijeve energjike personave nën 18 vjeç". Shkelja e kësaj dispozite do të përbëjë kundërvajtje administrative dhe do të dënohet me gjobë në masën 10 mijë lekë.

III. INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN VENDAS DHE TË HUAJ

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në vlerësimin e projektligjit ka mbajtur parasysh përvojën mbi ligjet dhe rregullat për pijet energjike të disa shteteve evropiane dhe botërore duke filluar me Argjentinën ku *“senati ka propozuar ndalimin e pijeve energjike në klubet e natës”*; Australia e cila *“i klasifikon pijet energjike si produkte farmaceutike, produktet të cilat janë të rregulluara”*; Danimarka – *ndalon plotësisht pijet energjike*; Kanadaja *“kërkon vendosjen e etiketave paralajmëruese, rekomandon një maksimum të sasisë ditore që mund të konsumohet dhe këshillohet që të mos përzihen pijet energjike me alkool deri sa të kryhen studime të mëtejshme”*; Franca e cila *“kërkon që të etiketohen si me ‘përmbajtje të lartë kafeine’ pijet që përmbajnë më shumë se 150 mg/L kafeinë si ‘jo të rekomandueshme për fëmijët dhe gratë shtatzëna ose për prsonat e ndjeshëm nga kafeina’ duke saktësuar sasinë maksimale që mund të konsumohet”*; Uruguai dhe Turqia kanë ndaluar plotësisht përdorimin e pijeve energjike; Suedia përcakton *“pijet energjike mund të shiten vetëm në farmaci. Ndalohej shitja e pijeve energjike për fëmijët më të vegjël se 15 vjeç dhe vendosen etiketa paralajmëruese për konsumimin e niveleve të larta të kafeinës dhe përzierjes me pije energjike”*; Zvicra *“pijet energjike nuk u shiten fëmijëve nën moshën 15 vjeç. Gjithashtu ekzistojnë shume paralajmërime rreth mospërdorimit të pijeve energjike në përzierje me pijet alkoolike”*

Që nga viti 2011, një numër i vendeve të OECD-së kanë forcuar kuadrin rregullator përsa i takon marketingut të ushqimeve dhe pijeve jo të shëndetshme për fëmijët. Të paktën shtatë vende të OECD-së kanë ndërmarrë politika shtrënguese për mbrojtjen e të miturve nga reklamimi në mediat audiovizive të produkteve me përmbajtje të lartë sheqëri, kripe dhe yndyre.

Konsumi dhe përkufizimet e pijeve energjike janë të saktësuara nga European Food Safety Authority (EFSA), i cili saktëson se “pijet që përmbajnë më shumë se 150mg/L kafeinë duhet të etiketohen ‘me përmbajtje të lartë kafeine’ dhe të tregojnë sasinë e saktë në etiketë.

Organizata Botërore e Shëndetësisë rekomandon që marrja e sheqernave të shtuar të jetë kufizuar në më pak se 10% të kalorive totale dhe nëse është e mundur konsumi duhet të kufizohet në më pak se 5%. Në të njëjtën linjë shkojnë edhe *“Udhëzimet kombëtare të dietës”* në SHBA gjatë viteve 2015-2020, të cilat gjithashtu sugjerojnë se më pak se 10% e kalorive/ditë duhet të vijnë nga shqernat e shtuar, ndërsa *Shoqata Amerikane e Zemrës* rekomandon konsumin e shqerit në fëmijë të kufizuar në më pak se 25 gr në ditë.

Për të reduktuar rreziqet nga konsumi i pijeve energjike, OBSH-ja u rekomandon agjencive qeveritare:

- Vendosjen e një kufiri të kafeinës në të gjitha produktet.
- Hartimin dhe forcimin e kërkesave ligjore të etiketimit dhe kufizimetve të shitjeve për të miturit.
- Forcimin dhe zbatimin e rregulloreve të industrisë për të tregtuar me përgjegjësi produktet e tyre.
- Trajnimin e punonjësve të kujdesit shëndetësor për të njohur dhe trajtuar mbidozën nga pijet energjike.
- *Screening* të pacientëve me një histori të abuzimit të substancave për konsum të rëndë të pijeve energjike.
- Edukimin e publikut për rreziqet e përzirjes së pijeve energjike me alkoolin.
- Hulumtimin e vazhdueshëm të efekteve anësore negative të pijeve energjike për të rinjtë

Gjithashtu Komisioni ka marrë parasysh legjislacionin evropian mbi etiketimin e ushqimit, duke i kushtuar një vëmendje të vecantë me vëmendje rregullave në lidhje me pijet që përmbajnë përbërës aktivë:

- Direktiva 2000/13/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi "Përafrimin e ligjeve të vendeve anëtare lidhur me etiketimin, prezantimin dhe reklamimin e produkteve ushqimore".

Direktiva përcakton informacionin e detyrueshëm ushqimor që sigurohet nga prodhuesit, me qëllim që të sigurohet një nivel i lartë i mbrojtjes së shëndetit dhe interesave të konsumatorëve. Sipas kësaj Direktive, në mesin e karakteristikave të tjera (sic është emri i ushqimit) është e detyrueshme të tregohet lista e përbërësve dhe sasia e përbërësve të caktuar ose kategorisë së përbërësve në etiketën e produktit.

- Direktiva 2002/67/EC e Komisionit Evropian për "Etiketimin e produkteve ushqimore që përmbajnë kininë dhe të produkteve ushqimore që përmbajnë kafeinë".

Direktiva përcakton që pijet që përmbajnë më shumë se 150 mg kafeinë për litër duhet të etiketohen me termin "Përmbajtje të lartë të kafeinës", në një pozicion të afërt me emrin e ushqimit. Për më tepër një tregues i qartë i sasisë së kafeinës për 100 ml në produkt duhet të sigurohet në etiketë. Në këtë Direktivë, pijet energjike tregohen qartë si produkte që përmbajnë kafeinë, të cilat sipas opinionit të 21 Janarit 1999 të Komitetit Shkencor për Ushqimin nuk paraqesin ndonjë shqetësim për kontributin e tyre në konsumin e përgjithshëm të kafeinës vetëm për të rriturit (përfshijto gratë shtatzëna).

- Rregullorja (BE) Nr 1169/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi "Dhënien e informacionit të ushqimit për konsumatorët"

Nga data 14 Dhjetor 2014 kjo Rregullore zbaton etiketimin shtesë të kafeinës për pije me përmbajtje të lartë kafeine dhe ushqime ku shtohet kafeina për efektet e saj fiziologjike. Në vecanti, kategoritë e mëposhtme të pijeve duhet të etiketohen me deklaratën "Përmbajtje e lartë e kafeinës. Nuk rekomandohet për fëmijët ose gratë shtatzëna ose ato që ushqejnë me gjë", të vendosura afër emrit të produktit dhe pasuar nga përmbajtja e kafeinës të specifikuar në mg per 100 ml:

- Pije të destinuar për konsum pa modifikim, që përmbajnë të paktën 150 mg/l kafeinë;
- Pije në formë të koncentruar ose të thatë që pas rikonstruktimit përmbajnë kafeinë në një proporcion më të madh se 150 mg/l

IV. PROCESI I KONSULTIMIT PUBLIK NË KUVEND TË PROJEKTLIGJIT

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në kuadër të gjithpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë dhe ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, e dërgoi projektligjin për mendim pranë institucioneve që preken nga fusha e zbatimit të tij si: Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH), organizata ‘Save the Children’, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), i cili është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe organizatës CRCA.

Në adresë të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë nuk janë paraqitur sugjerime apo opinione në lidhje me dokumentin e dërguar.

V. ÇËSHTJET E DISKUTUARA NË MBLEDHJEN E PËRBASHKËT TË ZHVILLUAR NGA TË DY KOMISIONET

Pas prezantimit dhe gjatë shqyrtimit të këtij projektligji nga Z. Brace dhe nga relatorja dhe anëtarët e dy komisioneve u theksua rëndësia e miratimit të këtij projektligji, i cili reflekton eksperiencën e vendeve të Bashkimit Evropian dhe më gjërë, rekomandimet e organizmave ndërkombëtare në këtë fushë, shqetësimet e raportimeve nga institucionet shqiptare përgjegjëse për monitorimin e shëndetit publik pasi projektligji adreson problematikat e lindura nga marketimi, mosinformimi dhe abuzimi në shumë raste, me pijet energjike dhe pijet e gazuara me sheqer të shtuar nga të mitur dhe persona madhorë që janë shoqëruesit e tyre.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, diskutimi në komision u përqëndruara në disa çështje kryesore:

- Diskutime të rëndësishme pati në lidhje me implementimin e projektligjit. U diskutua në lidhje me vlerësimin real të kapaciteteve që gjenden në praktikë për ndjekjen dhe zbatimin e ligjit. U shpreh vlerësimi në lidhje me nevojën e forcimit të këtyre kapaciteteve.
- Kuvendi i Shqipërisë duhet të rrisë rolin e tij sa i përket kontrollit parlamentar në mënyrë që të ndiqet zbatimi i ligjeve në praktikë. Mund të organizohen dhe kërkohen seanca dëgjimore me operatorin ekonomik, i cili tregton këto produkte, në mënyrë që të informohen me propozimet e ligjit duke u kërkuar dhe bashkëpunimin e tyre në zbatimin sa më efikas të ligjit.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të kryejë me përgjegjësi rolin e saj monitorues në lidhje me impaktin që këto masa, përmes këtij ligji dhe ligjeve të ngjashme, kanë në shëndetin e fëmijëve. Duhet ndërmarrë një vlerësim si social ashtu dhe financiar nga kjo ministri në lidhje me efektet në praktikë të ligjit.

- Ndërmarrja e fushatave sensibilizuese/ndërgjegjësuere në lidhje me informacionin që i duhet dhënë familjeve dhe fëmijëve. Sa i përket sensibilizimit duhet punuar ngushtë me ministritë përkatëse.

VI. NDRYSHIMET E MIRATUARA NGA ANËTARËT E DY KOMISIONEVE

Ndryshimet dhe shtesat kryesore të propozuara, në raport me nismën e propozuar nga deputeti Z. Erion Brace dhe nga relatorja Znj. Rista u bënë nga deputetët e të dy komisioneve, nga Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë si komision përgjegjës dhe Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, si komision për dhënie mendimi. Para miratimit të tyre, pati një dakordësi me propozuesin e projektligjit.

Ndryshimet e miratuara gjatë diskutimit të projektligjit nga anëtarët e të dy komisioneve paraqiten si më poshtë vijon:

- Neni 5, i projektligjit që ndryshon nenin 4 të ligjit “Ndalime për përdorimin e alkoolit” bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - Në paragrafin e dytë të ligjit aktual pas fjalës “restorant” shtohet fjala “kinema”
- Neni 8 i projektligjit ndryshon nenin 8 të ligjit aktual “Ndalimi i pijeve alkoolike në institucionet arsimore” shton:
 - *Në titull dhe kudo në nen pas fjalëve “në institucionet arsimore” shtohen fjalët “parauniversitare dhe qendrat e mbrojtjes sociale për fëmijë/ qendrat e përkujdesjes për fëmijë”*
- Në nenin 9 të projektligjit që ndryshon nenin 9 të ligjit aktual “Ndalimi i publicitetit për pijet alkoolike në mediat vizive”, pika 1 riformulohet si më poshtë vijon:
 - *“ndalohet trasmetimi i publicitetit për pijet alkoolike, pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në brendësi të këtij programi drejtuar të miturve, si dhe 60 minuta para dhe pas këtij programi”*
- Në nenin 11 të projektligjit “Kundërvajtjet administrative”, i cili ndryshon nenin 11 të ligjit bëhen këto ndryshime:
 - Në pikën 2/2 pas fjalës “restorantet” shtohet fjala “kinema”

Pas shqyrtimit, projektligji u miratua në parim, nen për nen dhe në tërësi me votat e anëtarëve të pranishëm të dy komisioneve dhe i përcillet për votim seancës plenare.

RELATORE

ADELINA RISTA

KRYETARE

ELISA SPIROPALI

KRYETARE

MILVA EKONOMI